

Përkujdesuni të mbroni veten dhe të tjerët nga COVID-19

Veçohuni në mënyrë të sigurt në një dhomë falas hoteli privat.


Nëse jeni diagnostikuar me COVID-19 apo nëse keni qenë në kontakt me dikë që ka rezultuar pozitiv, mund të kualifikoni për një dhomë hoteli për deri në 10 ditë për t'u veçuar në mënyrë të sigurt dhe për të mbrojtur të tjerët.

Hotelet e përkujdesjes janë të sigurt, komodë dhe praktikë. Të gjitha shërbimet janë falas. Fëmijët janë të mirëpritur.

Nëse zgjidhni të veçoheni në një hotel përkujdesjeje, kjo nuk do të ndikojë në përfitimet e tjera që merrni. Hotelet e përkujdesjes nuk ndikojnë në mundësinë tuaj për të aplikuar për një kartë të gjelbër. Për më tej, trajtimi mjekësor apo shërbimet e kujdesit shëndetësor parandalues në lidhje me COVID-19 NUK do të preken nga rregulli i barrës publike.

Shërbimet e mëposhtme ofrohen FALAS në hotelet e përkujdesjes:

- Transporti vajtje-ardhje në hotel dhe vizitat e mundshme e të nevojshme mjekësore
- Dhomat private dhe banjat
- Testimi në vend për COVID-19
- Wi-Fi dhe televizion kabllor falas
- Telefonata pa kufizim për të ruajtur kontaktin me njerëzit
- Mëngjes, drekë dhe darkë çdo ditë*
- Shërbime përkthimi me gojë
- Dërgesa mjekësore
- Shërbime të kujdesit shëndetësor në vend që ofrohen nga mjekë e infermiere të afta
- Telepsikiatri për të shfrytëzuar ofruesit ekspertë të shëndetit mendor



Prenotojeni dhomën tuaj sot.
Telefononi në nr. 212-COVID-19
(212-268-4319)
ose vizitoni testandtrace.nyc

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Community
Care

Test & Trace
Corps